




Ali Suleiman Ali

NJË HYRJE E SHKURTËR  
NË INTERPRETIMIN E  
KUPTIMEVE TË KURANIT





NJË HYRJE E SHKURTËR  
NË INTERPRETIMIN E  
KUPTIMEVE TË KURANIT

*Një hyrje e shkurtër në interpretimin e kuptimeve të Kuranit* (Albanian)  
Ali Suleiman Ali

Copyright © Center for Advanced Studies and the International Institute of Islamic Thought (IIIT), First Edition 1442AH / 2021CE

ISBN: 978-9928-126-38-2 Paperback

Translated into Albanian from the English Title:  
*A Brief Introduction to Qur'anic Exegesis*  
Ali Suleiman Ali

Copyright © The International Institute of Islamic Thought (IIIT), First Edition  
1438AH / 2017CE

ISBN: 978-1-56564-688-9 Paperback  
978-1-56564-699-5 Hardback

IIIT  
P.O. Box 669  
Herndon, VA 20172, USA  
www.iiit.org

IIIT London Office  
P.O. Box 126  
Richmond, Surrey  
TW9 2UD, UK  
www.iiituk.com

PËRKTHIMI  
KONSULENT SHKENCOR  
REDAKTIMI SHKENCOR  
REDAKTIMI GJUHËSOR  
KOORDINATORE  
FAQOSJA DHE DIZAJNI  
BOTUES

Ardian Muhaj  
Prof. Ass. Dr. Ramiz Zekaj  
Lavdrim Hamja  
Oriola Sula  
Anisa Hykaj  
Suhejb Xhemaili  
Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam  
www.aiitc.net / contact@aiitc.net  
Shtypshkronja dhe Shtëpia Botuese "Mileniumi i Ri"  
Autostrada Tiranë-Durrës, km 26  
Cel: +355 672063702  
email: info@mileniumiri.al  
web: www.mileniumiri.al

SHTYPUR NGA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Në varësi të përjashtimit ligjor dhe dispozitave të marrëveshjeve përkatëse të licencimit kolektiv, nuk lejohet asnjë riprodhim i asnjë pjese, pa lejen me shkrim të botuesve.

Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë libër janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë medoemos edhe ato të botuesit. Botuesi nuk mban përgjegjësi për saktësinë e adresave të jashtme, ose të faqeve të internetit të palëve të treta, të cituara në këtë botim, dhe nuk garanton se përmbajtja e faqeve të tilla është ose do të vazhdojë të jetë e saktë ose e përshtatshme.

---

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Ali, Suleiman Ali  
Një hyrje e shkurtër në interpretimin e kuptimeve të  
Kuranit / Ali Suleiman Ali ; përkth. Ardian Muhaj. –  
Tiranë AIITC, 2021  
196 f. ; 21 cm.  
Tit. origj.: A brief introduction to Qur'anic exegesis. – Bibliogr.  
ISBN 978-9928-126-38-2

1.Feja islame 2.Kurani 3.Kritika, interpretimi

Ali Suleiman Ali



# NJË HYRJE E SHKURTËR NË INTERPRETIMIN E KUPTIMEVE TË KURANIT

Përkthimi:  
Ardian Muhaj



Tiranë, 2021



Botimi i këtij libri u mbështet nga Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam (IIIT) dhe Qendra për Studime të Avancuara (CNS).



## Përmbajtja

Parathënie.....	7
Kapitulli I / Një vështrim historik.....	11
Kapitulli II / Tefsiri në shekujt e tretë dhe të katërt hixhri.....	29
Kapitulli III / Tefsiri i mbështetur në traditë: <i>Et Tefsir bil me'thur</i> .....	59
Kapitulli IV / Tefsir dhe fetva të shokëve të Profetit (sahabëve) .....	71
Kapitulli V / Tefsiri dhe fetvatë e pasuesve (tabiinëve).....	113
Kapitulli VI / Tefsiri i bazuar në logjikë: <i>Tefsi bi er ra'j</i> .....	139
Kapitulli VII / Prirje në interpretimin kuranor bashkëkohor.....	171
Fjalorth.....	187
Bibliografi.....	191





## Parathënie

*Në Emër të Zotit, Bamirësit të Përgjithshëm, Mëshiruesit të Pakufishëm.*

“... Ndërsa ty (o Muhamed) të zbritëm Përkujtesën (Kuranin), me qëllim që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur dhe që ata të mendojnë!” (Kuran, *En Nahl*: 44)<sup>1</sup>

Kurani është shpallja përfundimtare për njerëzimin. Është burimi i parë i Ligjit islam ose Sheriatit. I drejtohet, para së gjithash, njerëzimit për udhëzim në të gjitha aspektet e jetës, shpirtërore, politike, ekonomike, shoqërore, etj. Është drita që ndriçon rrugën e saktë dhe të drejtë të njeriut. Prandaj, që nga koha e Profetit Muhamed (a.s.) deri në ditët e sotme, muslimanët ia kanë kushtuar jetën studimit të Kuranit, duke medituuar mbi mësimet e tij, duke nxjerrë mësimet të dobishme, duke analizuar ngjarjet që ndodhin në tokë në dritën e këtij burimi të përjetshëm hyjnor. Si rezultat i këtyre përpjekjeve, ne kemi trashëguar një korpus mbresëlënës të njohurive rreth Islamit. Kurani është vërtet nëna e të gji-

---

1 Të gjitha citimet nga Kurani janë sipas përkthimit të Prof. Hasan I. Nahit. *Kurani i Madhërishtëm*. Përktheu kuptimet e tij nga gjuha arabe: Prof. Hasan I. Nahi. Përgatiti për botim: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, 2006. (Shën. i botuesit shqip)



tha shkencave islame. Mund të thuhet saktë dhe drejt, se të gjitha shkencat islame, nga Hadithi (thëniet, veprimet dhe miratimi i he-shtur i Profetit Muhamed) dhe parimet e Jurisprudencës islame (*usul el fikh*), te gramatika arabe (*nahv*) dhe retorika (*belegah*), të gjithë mbajnë gjurmën e Kuranit. Kështu, njohuritë në lidhje me evolucionin e tefsirit, si shkencë e interpretimit të Kuranit (ose shpjegimit kuranor), janë shumë të rëndësishme dhe të dobishme jo vetëm për myslimanët, por edhe për jomyslimanët.

Ky libër synon të prezantojë studentët e shkencave të tefsirit me zhvillimin historik të interpretimit kuranor nga koha e Profetit Muhamed, deri në ditët e sotme. Punimi thekson natyrën, karakteristikat dhe metodologjinë e tefsirit të Profetit. Por, gjithashtu, diskuton tefsirin e sahabëve të Profetit, gjithashtu tefsirin e tabinëve, domethënë, të brezit që pasoi sahabët, përfshirë statusin, karakteristikat dhe metodologjitë e tefsirit të tyre.

Përmbledhjet e ndryshme të llojeve të ndryshme të tefsirit që dolën si dhe autorët e tyre, janë përfshirë në këtë vepër. Janë trajtuar dy llojet kryesore të tefsirit. Libri, gjithashtu, hedh dritë mbi disa prirje të reja në tefsirin, në botën bashkëkohore, duke nënvizuar disa ndryshime midis veprave klasike dhe atyre moderne.

Për më tepër, puna është hartuar për të qenë e shkurtër dhe përshtetshme, jo analitike. Kjo për shkak se qëllimi kryesor ka qenë t'u sigurojë lexuesve informacione themelore në lidhje me evolucionin e tefsirit, disa interpretuesve kryesorë të Kuranit (mufessirun) dhe veprave të tyre. Shpresojmë që kjo hyrje e shkurtër të jetë me interes të madh për studentët e tefsirit dhe t'i inkurajojë ata të ndjekin kërkime në temën e trajtuar.

Aty ku datat citohen sipas kalendarit islamik (hixhri), ato etiketohen h. Përndryshe, ato ndjekin kalendarin Gregorian të etiketuar, kur është e nevojshme, (e.s.). Fjalët arabe janë shkruar të pjerrëta, përveç atyre që kanë hyrë në përdorim të zakonshëm. Shenjat diakritike u janë shtuar vetëm atyre emrave arabë që nuk konsiderohen modernë. Përkthimet në anglisht të marra nga refe-

rencat arabe, janë të autorit.

Që nga themelimi i tij në vitin 1981, IIIT ka shërbyer si një qendër kryesore për të lehtësuar përpjekjet serioze të studiuesve. Në drejtim të këtij qëllimi, gjatë dekadave, ka kryer programe të shumta kërkimore, seminare dhe konferenca, si dhe botimin e punëve shkencore të specializuara në shkencat shoqërore dhe fushat e Teologjisë, të cilat deri më sot numërojnë më shumë se katërqind tituj në anglisht dhe arabisht, shumë prej të cilave janë përkthyer në gjuhë të tjera kryesore.

Dëshirojmë të falënderojmë autorin, ekipin botues dhe të prodhimit në Zyrën IIIT të Londrës, si dhe të gjithë ata që kanë qenë të përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në përfundimin e këtij libri. Zoti i shpërbleftë për të gjitha përpjekjet e tyre!

*Janar 2017*





## KAPITULLI I NJË VËSHTRIM HISTORIK

### Përmbledhje

Dijen e interpretimit ose sqarimit të kuptimeve të Kuranit në tërësinë e saj e kemi paraqitur përmes përkufizimit bazë të terminologjisë, çfarë domethënie ka dhe si është zhvilluar përgjatë shekujve.

Kemi dhënë një paraqitje të interpretuesve ose sqaruesve më të mirë dhe të veprave të tyre, duke renditur tituj kryesorë të tefsirit.

Qartazi, Kurani ka shumë shtresa kuptimi dhe elemente të tjera të shumta (ajeti 59: 21 thotë: “Sikur këtë Kuran t’ia shpallnim ndonjë mali, ti do ta shihje atë (mal) të përulur dhe të copëtuar nga frika e Allahut”). Por pyetja është, a kemi ne si qenie njerëzore qasje në këtë kuptim? Interpretimi i kuptimeve kuranore përfshin kuptimin, sqarimin dhe interpretimin e çdo ajeti. Po, a marrim ne kuptimin e dukshëm e të qartë, apo përiqemi të shohim nën sipërfaqe dhe të zbulojmë të tjera më të fshehura? A kemi aftësi ta bëjmë këtë? A duhet ta bëjmë, duke pasur parasysh aftësitë tona të kufizuara, dhe a duhet t’i përmbahemi vetëm asaj që dimë nga traditat profetike?

Cilat standarde metodologjike duhet të zbatohen në shpjegimin kuranor? A duhet të mbështetemi vetëm në hadithet dhe komentet e sahabëve? Apo, duke pasur parasysh faktorin kohë-hapësirë, duhet të përvetësojmë një nivel arsyetimi dhe / ose të kuptimit arsyetues të interpretimit të tekstit?

Këto dhe pyetje të tjera përbërëse të shpjegimit kuranor i kanë shoqëruar muslimanët përgjatë shekujve. Kjo ka çuar në interpretues që lavdërojnë, kritikojnë dhe madje që kundërshtojnë njëri-tjetrin. Ky kapitull jep një përmbledhje të shkurtër të çështjeve të përfshira.

Shkenca e Tefsirit ka si qëllim shpjegimin e kuptimeve të fjalës së Allahut, ashtu siç i janë shpallur në Librin e Tij të Shenjtë, në Kuran, të Dërguarit të Tij, Muhamedit (a.s.), dhe zakonisht, quhet si komentar ose “interpretim” kuranor dhe është një nga shkencat kryesore islame. Rrënja arabe f-s-r do të thotë të zbulosh, të shpalosh<sup>2</sup> dhe studiuesit tradicionalë ose klasikë muslimanë pohojnë se emri foljor tefsir rrjedh nga *fessera*, që do të thotë të shpjegosh. Termat *fessera*, *tefsirah* dhe *tefsir* kanë domethënien e shpjegimit, sqarimit, shpalimit dhe zbulimit.

*Tefsir*, që fjalë për fjalë do të thotë “shpjegim”, dhe *te’vil* - “interpretim”, janë dy terma që zakonisht përdoren nga studiuesit si sinonime ose të këmbyeshëm, për të emërtuar interpretimin ose shpjegimin kuranor. Të dy këta terma rrjedhin nga folje kahlitare, megjithëse termi *tefsir* përdoret më shumë për kuptimin e tij të përmbledhur.<sup>3</sup> Sipas leksikografëve arabë, fjala *te’vil* është e prejardhur ose nga fjala *evvele* (për t’u kthyer, ose për të arritur në cakun e fundit) dhe / ose *ijeleh* (kuptimi rrënjësor i emrit foljor *āla*, për të rregulluar, ose për të formësuar).

2 Es Sujuti, Xhelaludin Abdurrahman ibn Ebu Bekr, *El Itkan fi el Ulum el Kur’an*, bot. i parë, (Bejrut: Dar el Kutub el Imijeh, 1987/1407).

3 Ibn Ashur, Muhamed, el Tahir, *EtTahrir ve et Tenvir* (Tunis: Ed Dar et Tunisije li et Tiba’ah ve en Neshr, n.d.), vëll. I, f. 5.

## DALLIMI NDËRMJET *TEFSIRIT* DHE *TE'VILIT*

Sipas Muhamed ibn Muhamed El Maturidi (vd. 333h.), *tefsiri* është shpjegimi i kuptimit të plotë të tekstit që zbulon atë që Zoti synon veçanërisht nga teksti, ndërsa *te'vil* ka të bëjë me gjetjen e interpretimin më të gjasshën (përafërt), kur teksti ka më shumë se një kuptim të mundshëm.<sup>4</sup> Husejn ibn Muhamed er Ragibel Esfahani (vd.502 h.) pohonte se *tefsiri* është më gjithëpërfshirës se *te'vili* dhe përdoret më shpesh për të kuptuar shpjegimin e fjalëve dhe termave të veçuar. *Te'vili*, shpesh, përdoret për të sqaruar kuptime dhe fjali dhe përdoret më së shumti në tekste teologjike ose libra, ndërsa *tefsiri* përdoret në tekste teologjike dhe në fusha të tjera (të tilla si shkencat e Kuranit dhe Jurisprudencës islame).<sup>5</sup> Nga ana e tij, Sujuti pohon se *te'vili* është e dhëna mbi kuptimin e synuar real, ndërsa *tefsiri* është e dhëna mbi shenjimin e kuptimit.<sup>6</sup> Studiues të tjerë e kuptojnë *tefsirin* si shpjegim të Kuranit, bazuar në hadithet e përcjella nga i Dërguari, Shokët e tij dhe Pasuesit, ndërkohë që e konsiderojnë *te'vilin* si njohuri vetjake, që shkon përtej kuptimit të dukshëm. Shembulli i mëposhtëm mund të ndihmojë në sqarimin e kësaj pike. Lexojmë në suren En Nasr: 1-3:

Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe, atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve!<sup>7</sup>

*Tefsiri*, ose kuptimi i këtyre ajeteve, është kuptimi i dukshëm, siç tregohet në përkthim. Mirëpo *te'vili* i ajeteve është mënyra se si Abdullah Ibn Abasi i ka interpretuar ato. Ai ka thënë se kjo sure,

4 Sujuti, *El Itkan*, vëll. 2, f. 382.

5 Po aty, vëll. 2, f. 381.

6 Po aty, vëll. 2, f. 439.

7 Ibn Kethir, el Imam el Hafiz el Kurashi ed Dimashki, *Muhtesar Tefisir Ibn Kethir*, ed., Muhamed Ali es Sabuni, bot. i ri, (Dar el Me'arifeh, 1994), vëll. 2, f. 348.

ose këto ajete së bashku, paralajmëruan kalimin e afërt të Profetit Muhamed në jetën e pasosur. Sipas këtij interpretimi personal, i Dërguari është një Lajmëtar dhe misioni i tij kishte marrë fund me pranimin e Islamit nga njerëzit në Arabi. Kështu, ai duhej të kthehej te Zoti, i Cili e dërgoi.

Megjithatë, Ebu Ubejde Muammer ibn el Muthenna (vd. 210 h.) dhe Et Tabariu ndryshojnë në përkufizimet e cituara më lart të tefsirit dhe te'vilit. Ata mendojnë se nuk ka asnjë ndryshim midis dy termave, të cilat i konsiderojnë si sinonime.<sup>8</sup> Termi tefsir, sipas asaj që kam mundur të zbuloj unë, kur përdorej për të nënkuptuar shpjegimin e Kuranit, është zhvilluar nga gjysma e dytë ose fundi i shekullit të parë hixhri. Me gjasë, ka qenë Abdullah ibn Omer i pari që ka përdorur fjalën tefsir për të nënkuptuar interpretimin e Kuranit, kur pohon: “*ma juxhibuni xhura’atu ibn Abbas ala tefsir el Kur’an. El ene kad alimtu ennehu utije ilmen*” (Nuk më pëlqen, ose nuk e admiroj Ibn Abasin për guximin e tij në komentet kuranore, por tani e di që atij i është dhënë dije).<sup>9</sup> Në fakt, nuk gjejmë asnjë përmendje të këtij termi në Kuran dhe Hadith, që të nënkuptojë shpjegimin e kuptimit të Kuranit. Kurani, nga ana tjetër, përdori fjalën tefsir në një vend (El Furkan:33) për të nënkuptuar “shpjegim”: “*ve la je’tuneke bimethilin il’la xhina’ke bil hakki ve ahsene tefsiren*” (Sapo ata të të sjellin çfarëdo argumenti, Ne të sjellim të Vërtetën dhe shpjegimin më të mirë). Termat që përdorin Kurani dhe Hadithi për interpretimin kuranor, janë *bejan*, *tebjin*, *te’vil* dhe *kavl*.

Pasazhet e mëposhtme të Kuranit dhe Hadithit mbështesin thënien time:

Ne e kemi për detyrë t’i mbledhim pjesët e tij e ta lexojmë atë. Dhe, kur ta lexojmë atë, ti përcille leximin e tij! Pastaj, e kemi Ne për detyrë ta shpjegojmë (bejanuhu).<sup>10</sup>

8 Ebu Xhafer Muhamed ibn Xherir et Tabari, *Xhami el bejjan an Te’vil el Kur’an*, bot., Mahmud Muhamed Shakir dhe Ahmed Muhamed Shakir, (Kajro: Dar el Me’arif), vëll. 2, f. 204.

9 Sujuti, *El Itkan*, vëll. 2, f. 413.

10 Kuran, El Kijame: 17-19.

Fjala *bejane* është përdorur për të kuptuar shpjegim ose sqarim.

Ndërsa ty (o Muhamed) të zbritëm Përkujtesën (Kuranin), me qëllim që t'u shpjegosh njerëzve qartë (li tubejjine) atë që u është shpallur dhe që ata të mendojnë. Dhe Ne ju kemi dërguar (gjithashtu) Mesazhin; që t'u shpjegoni njerëzve qartë "litubejjine" atë që u është dërguar atyre ...<sup>11</sup>

Në këtë ajet, fjala *li tubejjine*, emri foljor (*masdar*) i së cilës është *tebjin*, i referohet shpjegimit ose sqarimit të vargjeve kuranore.

Ajeti 7 i sures Ali Imran të Kuranit thotë: "Por kuptimin e tyre të vërtetë (te'vil) e di vetëm Allahu". Fjala te'vil nënkupton kuptimin ose interpretimin e vërtetë. Në një hadith të njohur, Profeti Muhamed i kërkon Allahut, që t'i japë Ibn Abbasit njohuri, si për të kuptuarit e dinit (fesë, Islamit), ashtu edhe të Kuranit: "*Allahumme fekkihu fi ddin ve al'limhu et te'vil*", që do të thotë: 'O Zot, jepi atij njohuri në fe dhe mësoji shpjegimin ose interpretimin e Kuranit!'"<sup>12</sup>

Në përmbledhjen e Hadithit të Tirmidhiut, një transmetim thotë: "*men kale fi el Kur'an bi ra'jhi fel jetebeve mek'adehu min en nar*",<sup>13</sup> që do të thotë: "Kushdo që interpreton Kuranin, duke përdorur mendimin e vet, le të zërë vendin e tij në zjarr". Termi *kale* (ka kuptimin "thotë") në kontekstin e këtij hadithi, i referohet interpretimit të Kuranit. Për më tepër, si i Dërguari, ashtu edhe sahabët, kanë interpretuar në mënyrë alegorike disa ajete kuranore. Megjithatë, interpretimet e tyre, zakonisht, janë quajtur tefsir dhe jo te'vil. Kjo, mendoj, vjen për shkak se shumë prej dijetarëve të tefsirit, nëse jo shumica, nuk kanë parë ndonjë ndryshim midis dy kuptimeve.

Përdorimi i këtyre termave në Kuran dhe Hadith na çon të mendojmë se një pjesë e interpretuesve të Kuranit (*mufessirun*),

11 Kuran, En Nahl: 44.

12 Ibn Haxher el Askalani, *Fet'h el Bari fi Sherh Sahih el Buhari*, (Kajro: El Matba es Selefijje, n.d.), vëll. 8, f. 265.

13 Et Tirmidhi, Ebu Isa Muhamed ibn Sevra, *Sunen et Tirmidhi*, red., Abdurrahman Muhamed Uthman, bot. i parë, (Kajro: Dar el Fikr, 1964/ 1383), vëll. 2, f. 397.



duke përfshirë dijetarë të tillë si Tabariu, Zamakhshari dhe të tjerë, i kanë përdorur fjalët bejan, te'vil dhe kavil në titujt e librave të tyre, për shkak të lidhshmërisë së këtyre termave me shpjegimin kuranor. Vepra voluminoze e Tabariut titullohet "*Xhami el Bejan an Te'vil ajet el Kur'an*), dhe libri i famshëm i tefsirit të Zamaksherit titullohet "*El Keshshaf an haka'ik et Tenzil ve ujun el akavil fil vuxhuh et te'vil*".

## PROFETI MUHAMED DHE TEFSIRI

Profeti Muhamed ishte komentuesi ose interpretuesi i parë i Kuranit (*mufessir*). Por ai, megjithatë, nuk e shpjegoi të gjithë Kuranin fjalë për fjalë, sepse shumë prej vargjeve ishin të qarta për njerëzit e kohës së tij, për shkak se ata, duke qenë arabë, e kuptonin qartë gjuhën e tyre. Në përgjithësi, shpjegimet e tekstit të Kuranit prej Tij, kanë ndodhur në një prej këtyre tri rasteve: kur një fragment i veçantë nuk mund të kuptohej përmes domethënies së zakonshme në arabisht; kur kuptimi i drejtpërdrejtë i një ajeti, sipas dijetarëve muslimanë, nuk ishte qëllim nga Zoti; ose kur një shok (sahab) ka kërkuar sqarimin e disa ajeteve. Për shembull, Ubade ibn es Samit e pyeti Profetin në lidhje me kuptimin e fjalës *bushra* (lajme të gëzueshme) në ajetet kuranore: "(Të tillë janë) ata që besojnë dhe që (i) frikësohen (Allahut). Ata i presin lajme të mira (*bushra*) në këtë jetë dhe në tjetrën. S'ka ndryshim në fjalët e Allahut; kjo është fitorja madhështore". Profeti u përgjigj: "Ti më ke pyetur diçka që askush nga Umeti im (bashkësia muslimane) nuk ka pyetur ndonjëherë para teje". Profeti shpjegoi se *Bushra* nënkuptonte në këtë ajet një ëndërr të mirë që dikush sheh, ose që shihet për të.<sup>14</sup>

Urdhri kuranor që ka të bëjë me kohën e prishjes së agjërimit gjatë muajit të Ramazanit, thotë: "Dhe hani e pini, derisa të

---

14 Ahmed ibn Hanbel, *el Fet'h er Rabbani li tertib musnad el Imam Ahmed ibn Hanbel* esh Shejbani, bot., Abdurrahman el Benna, (Kajro: Dar esh Shihab), vëll. 18, f. 175-176.

dallohet fija e bardhë (bardhësia) e agimit nga fija e zezë (errësi-  
ra e natës)!" (2:187). Për të qenë në përputhje me këtë rregull,  
Ubej ibn Hatim, i cili nuk e kuptonte këtë shprehje figurativisht,  
mbajti një fije të bardhë dhe të zezë, posaçërisht për të parë se  
kur drita e hershme e agimit do ta lejonte atë të dallonte fijet, në  
mënyrë që ai të fillonte agjërimin. Profeti Muhamed i shpjegoi  
atij, se filli i bardhë dhe i zi, të përmendur në ajetin kuranor, i  
referohen dritës së parë të agimit në horizont, në kontrast me  
errësirën e qiellit.<sup>15</sup>

## TEFSIRI PAS NDËRRIMIT JETË TË PROFETIT MUHAMED

Muslimanët që jetuan menjëherë pas vdekjes së Profetit, e pra-  
nuan epërsinë dhe aftësitë e sahabëve në lidhje me njohuritë  
kuranore. Para se të vdiste, i Dërguari shpalli statusin e tyre të  
lartë në lidhje me Kuranin, në tri mënyra.

Së pari, ai e kishte bërë zakon t'i dërgonte në qytete të tjera  
për të mësuar Kuranin dhe Islamin. Për shembull, ai e dërgoi  
Mus'ab ibn Umejrin në Medinë para hixhretit të përgjithshëm ose  
"emigracionit" të muslimanëve nga Meka në Medinë.<sup>16</sup> Ngjashëm,  
Ali ibn Ebi Talib (vd. 32 h.) dhe Mua'dh ibn Xhebel (vd. 18 h.) u  
dërguan në Jemen në kohë të ndryshme, për të udhëzuar musli-  
manët e rinj në lidhje me Islamin dhe të ftonin jomuslimanët ta  
pranonin atë.<sup>17</sup>

Së dyti, Profeti kishte lavdëruar sahabë të caktuar, si Abdu-  
llah ibn Mes'ud (vd. 32 h.), Ubej ibn Ka'b el Hazreth el Ensari

15 Et Tabari, *Xhami el bejjan*, vëll. I, f. 204.

16 Mus'ab ibn Umejri ishte ambasadori i parë në Islam. Ai u dërgua nga Profeti në  
Medinë për t'ua mësuar banorëve të Medinës Kuranin. Vdiq në betejën e Uhudit.

17 Ali ibn Ebi Talibi ishte kushëri dhe dhëndër i Profetit Muhamed. Ai ishte  
gjithashtu, Halifi i katërt.

(vd. 21 h.), Zejd ibn Thabit (vd. 45 h.) dhe Mu'adh ibn Xhebel, për aftësinë e tyre në recitimin e Kuranit, siç duhet dhe tërësisht.<sup>18</sup>

Së treti, ai u kishte kërkuar sahabëve të caktuar të jepnin fetva (argumentime juridike) në praninë e tij.<sup>19</sup> Për shembull, në raste të ndryshme, i ka kërkuar Ebu Bekr es Sidikut (vd. 13 h.), Omer ibn Hatabit (vd. 23 h.), Othman ibn Affanit (vd. 34 h.) dhe Ali ibn Ebi Talibit për ta bërë këtë në praninë e tij. Pas vdekjes së Profetit, muslimanët iu drejtuan këtyre shokëve dhe të tjerëve për të mësuar rreth Kuranit dhe tefsirit të tij. Sahabë të tjerë të shquar për aftësinë e tyre sqaruese, ishin Ebu Musa el Ashari (vd. 44 h.), Aishe bint Ebu Bekr es Sidik (vd. 58 h.), Ebu Derda Uvejmir Ibn Zejd (vd. 32 h.) dhe Abdullah ibn Zubejr (vd. 73 h.).

Pas vdekjes së Profetit dhe me përhapjen e Islamit, muslimanët u vendosën në tokat e dikurshme jomuslimane dhe morën përsipër përgjegjësinë e përhapjes së besimit dhe të mësimin të interpretimit dhe recitimit kuranor. Rrjedhimisht, u zhvilluan katër shkolla të ndryshme të interpretimit dhe këndimit të Kuranit (kira'a). Këto u identifikuan nga zonat në të cilat u bënë të njohura: Meka, Medina, Kufa (në zonën e Irakut të sotëm) dhe Shami (Palestina, Siria dhe Libani i sotëm).

## SHKOLLA MEKASE

Sipas Ibn Tejmijes (vd. 728 h.), interpretimi kuranor i shkollës së Mekës ishte më i miri, sepse ithtarët e saj ishin studentë të Ibn Abasit, mësuesit kryesor të shkollës mekase të tefsirit.<sup>20</sup> Shumica e njohurive që ai kishte në lidhje me interpretimin, Hadithin dhe shkencat e tjera, i mori përmes shokëve të shquar. Kjo, sepse ai

18 Ibn Sead, Muhamed ibn Sa'id ibn Meni ez Zuhri, *Et Tabakat el kubra* (Bejrut: Dar Sadir, 1957), vëll. 2, f. 107-110.

19 Po aty, vëll. 2, f. 98-99.

20 Ibn Tejmije, Takiudin Ahmed Abdulhalim, *Mukaddime fi usul et Tefsir*, ed., Adnan Zorzo, (Bejrut: Dar el Kur 'an el Kerim, 1979/1399), f. 61.

ishte vetëm trembëdhjetë vjeç, kur Profeti ndërroi jetë. Mësuesit e tij përfshinin Ali ibn Ebi Talib, Ubej ibn Ka'b, Zejd ibn Thabit dhe Omer ibn Hatabin. Lavdërimi i Ibn Abasit nga bashkëkohës të ndryshëm të Profetit përcillet gjerësisht në literaturën islame dhe atij iu dhanë tituj të nderuar, si ato të *ra's el mufesirun* (interpretuesi kryesor i Kuranit) dhe *hibr hadhihi el umme* (dijetari kryesor i bashkësisë muslimane).

Pas vrasjes së Ali ibn Ebi Talibit, të cilin Ibn Abasi e mbështeti dhe luftoi për të gjatë gjithë udhëheqësisë së stuhishme të Halifit, Ibn Abasi u kthye në vendlindjen e tij, Mekë. Deri në vdekjen e tij në Taif, rreth njëzet vjet më vonë, iu përkushtua mësimi të Kuranit dhe interpretimit të tij, historisë, jurisprudencës (fikhut), hadithit, arabishtes dhe poezisë. Klasat e tij ishin xhamia dhe shtëpia e tij, dhe nga të gjitha dëshmitë që na kanë mbërritur, oratoria e tij ishte e shkëlqyer dhe bindëse. Studentë nga qytete të ndryshme udhëtonin drejt Mekës për të mësuar prej tij, me rrethin e tij të mësimdhënies gjithmonë të mbushur plot, dhe studentët e tij të shumtë që vazhduan të përcillnin këto njohuri pas tij. Më të spikaturit prej tyre, ishin: Ikrimë el Berberi (vd. 105 h.), Said ibn Xhubejr (vd. 95 h.) dhe Muxhahid ibn Xhebr (vd. 104 h.). Muxhahidi ka marrë vlerësimin më të madh, sepse thuhet se ai e kishte recituar Kuranin ajet pas ajeti, tri herë në prani të Ibn Abasit,<sup>21</sup> megjithëse kjo nuk do të thotë se ai ishte tërësisht dakord me interpretimin e mësuesit të tij dhe se nuk kishte mendimin e tij në lidhje me interpretimin e disa vargjeve.

## SHKOLLA IRAKIANE

Sipas Ibn Tejmijes, Sujuti, Abdullah ibn Mes'udi (vd. 32 h.) e të tjerë, ishin themeluesit e Shkollës Irakiane të Tefsirit.<sup>22</sup> Abdullahu,

21 Sujuti, *El Itkan*, vëll. 2, f. 413.

22 Ibn Tejmije, *Mukaddime fi usul et Tefsir* f. 61.

personi i gjashtë që pranoi Islamit dhe një nga shkruarit ose kopjuarit e parë të Kuranit, lindi në Mekë dhe vdiq në Medinë. Ai ishte një nga katër sahabët të cilët Profeti i ka përmendur për recitimin e shkëlqyeshëm të Kuranit. Ibn Mes'udi ka pohuar se ka mësuar shtatëdhjetë kapituj të Kuranit direkt nga Profeti.<sup>23</sup> Bashkëkohësit e tij e vlerësonin shumë për njohuritë e tij për tefsirin, Hadithin dhe leximin, deri aty, sa Ebu Musa el Ashari (vd. 52 h.) u thoshte atyre që i vinin me pyetje të caktuara, “mos më pyesni asgjë, përderisa Ibn Mes'udi është mes jush”. Pas vdekjes së Profetit dhe para se Ibn Abasi u bë i njohur si më i miri në tefsir, askush nuk u ofendua prej pretendimit të Ibn Mes'udit, se ishte më i dituri në Islam në Kufeh. Ai është i njohur për thënien: “Nëse njoh dikë me njohuri më të madhe të Librit të Zotit se unë, mezi do të prisja ta takoja. Nuk ka asnjë ajet që unë nuk e di se ku dhe kur është shpallur”.<sup>24</sup>

Ibn Mes'udi u bë themeluesi i Shkollës së Kufes, kur Halifi Omer e dërgoi atje si këshilltar të guvernatorit të Kufes dhe për t'i mësuar Islamit popullatës së gjerë. Midis studentëve të tij të shumtë, më të spikatur ishin Mesruk ibn Exhda (vd. 63 h.), Alkame ibn Kajs (vd. 63 h.) dhe Hasan el Basri (vd. 110 h.).

## SHKOLLA E MEDINËS

Mësuesi kryesor i kësaj shkolle ishte Ubej ibn Ka'ab ibn Kajs el Hazraxhi el Ensari (vd. 21 h.), i cili ishte me origjinë hebraike, kishte lindur në Medinë dhe vdiq po aty. Ubej ishte një nga njerëzit e parë të Medinës, që pranoi Islamit para migrimit të Profetit në Medinë. Ai mori pjesë në të gjitha luftërat e Profetit. Ubej ishte një nga katër sahabët, leximi i Kuranit të të cilit u vlerësua nga vetë Profeti dhe u rekomandoi sahabëve që ta mësojnë

23 Ibn Sead, *Et Tabakat el kubra*, vëll. 2, f. 164.

24 Sujuti, *El Itkan*, vëll. 2, f. 413.

Kuranin prej tij. Ai, gjithashtu, mësoi përmendësh të gjithë Kuranin dhe dha fetva gjatë jetës së Profetit. Sipas Ibn Seadit, Profeti ka thënë që Ubeji ishte lexuesi më i mirë i Kuranit në bashkësinë e Profetit.<sup>25</sup>

Bashkëkohësit e Ubejit, të tillë si Ebu Bekr es Sidiku, Omer Ibn Hatabi dhe Othman ibn Affani, e pranuan diturinë e tij rreth Kuranit. Si Ebu Bekri, ashtu edhe Othmani e emëruan Ubejin në komitetin që mblodhi Kuranin.<sup>26</sup> Përcillet se Omer ibn Hatabi ka thënë: “Kush dëshiron të mësojë Kuran, le të shkojë tek Ubeji!”<sup>27</sup>

Pas vdekjes së Profetit Muhamed, Ubeji iu përkushtua mësimin të Kuranit dhe interpretimit të tij në Medinë. Studentë nga Shami dhe qytete të tjera vinin në Medinë posaçërisht për të mësuar prej tij.<sup>28</sup> Ubeji vazhdoi të jepte mësimin e Kuranit dhe tefsirit, derisa vdiq. Ndër studentët e shquar që transmetuan njohuritë e Ubejit, ishte djali i tij, Tufejl ibn Ubej (vd. 85 h.).

## SHKOLLA E SHAMIT

Mësuesi kryesor i kësaj shkolle ishte Umejr ibn Zejd ibn Kajs el Hazraxhi (vd.32 h.), i cili u konvertua në Islam në vitin e tretë pas hixhretit dhe ishte i njohur gjerësisht si Ebu Derda. Gjatë qëndrimit në Sham, ku më vonë vdiq, ai dha mësimin e Kuranit në xhaminë Emevite. Ebu Derda ishte një dijetar dhe asket i famshëm (*zahid*). Ai ishte një nga sahabët e paktë që përpiloi një kopje të Kuranit të shkruar me dorë, gjatë jetës së Profetit.<sup>29</sup>

---

25 Ibn Sead, *Et Tabakat el kubra*, vëll. 2, f. 164.

26 Zaglul, Shahatah es Sejjid, *Ubej ibn Ka'b:Er rexhul ve el Mus'haf*, bot. i parë, (Kajro: El Haja'eh el Misrijeje el Ammeh li el Kitab, 1978, f. 33-36.

27 Po aty, f. 28.

28 Ibn Asakir, *Tarih Dimashk*, vëll. 1, f.102.

29 Ibn Sead, *Et Tabakat el kubra*, vëll. 2, f. 125.

Kishte një numër studiuesish të rëndësishëm nga kjo shkollë. Një nga më të spikaturit ishte Abdurrahman Ibn Ganem el Ensari (vd. 78 h.),<sup>30</sup> i cili u dërgua në Sham nga Omer ibn Hatabi, si mësimdhënës i Kuranit dhe Sunetit.<sup>31</sup> Një student tjetër i shquar i kësaj shkolle ishte Raxh ibn Hajvah el Kindi (vd. 131 h.). Po ashtu, ishte edhe Omer ibn Abdulaziz ibn Mervan (vd. 101 h.), Halifi i tetë emevit. Ai u bë i njohur si një autoritet në jurisprudencë, shkenca kuranore e Hadith, si dhe fitoi një reputacion të madh për asketizmin (*zuhd*) dhe si udhëheqës i drejtë (*adil*).<sup>32</sup>

## TEFSIRI: NGA INTERPRETUESIT E HERSHËM, NË KOHËT MODERNE

### *Epoka e pasuesve (tabiinëve)*

Nga mesi i shekullit të parë, sahabët e shquar që ishin interpretes të Kuranit, kishin vdekur, me përjashtim të Ibn Abasit, që vdiq në vitin 68 hixhri. Në këtë kohë, tefsiri u mësua nga dije-tarët, duke përdorur arsyetimin e tyre të pavarur, bazuar në parimet e shëndosha të shkencave të tefsirit, ose kuptimit të shëndoshë të gjuhës arabe (*tefsir bi ra'j*) dhe transmetimit nga nxënësit e sahabëve, *tabiunët*. Ndër më të spikaturit, ishin Muxhahid

---

30 Hajredin ez Zirikli, *El Alam: Kamus Teraxhim li Eshhar er Rixhal vel en Nisa' min el Arab ve el Musta'ribin ve el Musteshrikin* (Bejrut: Dar el Ilm li el Melejin, 1980), vëll. 3, f. 322. Ibn Haxher el Askalani, *Tedhhib et Tedhhib*, vëll. 3, f. 265.

31 Ibn Sead, *Et Tabakat el kubra*, vëll. 2, f. 161.

32 Ez Zirikli, *El Alam*, vëll. 4, f. 96 ; Ebu Abdullah Shemsuddin Muhamed ibn Ahmed ibn Uthman edh Dhehebi, *Tedhkirat el Huffaz*, vëll. 1, f. 48.

ibn Xhebr,<sup>33</sup> Seid ibn Xhubejr,<sup>34</sup> Ikrime el Berberi,<sup>35</sup> Alkame ibn Kajs,<sup>36</sup> Mesruk ibnul Exhda,<sup>37</sup> Muhamed ibn Ke'ab el Kurazi,<sup>38</sup> Ebu el Alijeh Rafi ibn Mehram (vd. 90 h.),<sup>39</sup> Zejd ibn Eslem (vd. 13 h.),<sup>40</sup> Raxha ibn Hajvah (vd. 131 h.)<sup>41</sup> dhe Abdurrahman ibn Ganem (vd. 78 h.).<sup>42</sup> Secili prej këtyre dijetarëve ka mësuar nga shumë sahabë, edhe nëse secili prej tyre shoqërohej me një sahab për një periudhë prej shumë vitesh, duke u përmendur si student i atij sahabi të veçantë. Për shembull, Muxhahid ibn Xhebr, Seid ibn Xhubejr dhe Ikrime njiheshin si nxënës të Ibn Abasit, ndërsa Alkamah ibn Kajs dhe Mesruk ibnul Exhda ishin të njohur si studentë të Ibn

- 
- 33 Muxhahid ibn Xhebr ishte një student i famshëm i Ibn Abasit. Ai transmetoi tefsir dhe hadith nga më shumë se 12 sahabë dhe ishte burimi i transmetimit për më shumë se 28 tabi'inë (pasues) dhe transmetuesit e mëvonshëm të tefsirit, hadithit dhe jurisprudencës së fikhut. Ka thënë se e ka studiuar të gjithë Kuranin me Ibn Abasin, tri herë. Gjatë secilës seancë, ai ndalej në fund të secilit varg dhe pyeste Ibn Abasin për vendin dhe kontekstin e shpalljes së tij. Muxhahidi ishte përkrahur si kreu i mufesirëve dhe ishte i njohur si një *thikeh* (i besueshëm). Shih Dhehebi, *Sijer Alam en Nubela* (Kajro: Me'had el Mekhtutat el Arabijje, 1952-1956), vëll. 4, f. 449.
- 34 Seid ibn Xhubejr është një nga studentët e Ibn Abasit. Ai transmetoi tefsir dhe hadithe nga rreth 110 sahabë, dhe ishte burimi i rrëfimit për më shumë se 86 studentë të tij. Ibn Abasi e vlerësoi shumë njohurinë e tij. Kur njerëzit e Irakut erdhën tek Ibn Abasi, duke bërë pyetje fetare, ai u tha atyre: "Pse po më pyesni, kur keni dikë midis jush në Irak, si Seid ibn Xhubejr?" Seid ibn Xhubejr u njoh si *thikeh* (i besueshëm). Shih Dhehebi, *Sijer alam en Nubela*, vëll. 4, f. 328 dhe Ibn Sa'd, *Et Tabakat*, vëll. 6, f. 179.
- 35 Ikrime el Berberi ishte një student i shkëlqyer i Ibn Abasit dhe jetoi në shtëpinë e tij. Ikrime mësoi dhe transmetoi nga më shumë se 10 sahabë dhe ishte burimi i tregimit për më shumë se 20 tabi'inë dhe transmetues të mëvonshëm. Ibn Abasi i njohu publikisht meritat e tij dhe e inkurajoi të jepte fetva në praninë e tij. Ikrime deklaroi se nuk kishte asnjë ajet në Kuran, për të cilin nuk kishte dëgjuar disa informata. Disa nga bashkëkohësit e tij e përshkruan atë si el Behr (oqeani) dhe si i besueshëm. Shih Dhehebi, *Tedhkiret el Huffaz*, vëll. 1, f. 96.
- 36 Alkame është një nga studentët e shquar të Ibn Mes'udit. Ibn Haxher, *Tehdhib et tehdhib*, vëll. 7, f. 276-279.
- 37 Gjithashtu, një nga studentët e shquar të Ibn Mes'udit. Po aty, vëll. 7, f. 149.
- 38 Një nga studentët e Ubej ibn Ke'ab. Po aty, vëll. 9, f. 421.
- 39 Ebu el Alijeh ishte një nga studentët e Shkollës së Medinës. Dhehebi, *Sijer alam en Nubela*, vëll. 4, f. 207-212.
- 40 Ekzegjeti i shquar i Shkollës së Medinës. Dhehebi, *Tedhkirat el Huffaz*, vëll. 1, f. 132.
- 41 Një nga studentët e Shkollës së tefsirit të Shamit. Ibn Sead, *Et Tabakat el kubra*, vëll. 2, f. 161.
- 42 Një nga studentët e Shkollës së Shamit. Ibn Haxher, *Tehdhib et Tehdhib*, vëll. 3, f. 265.



Mes'udit.

Gjatë kësaj kohe, nisën të duken disa prirje të reja në interpretimin kuranor, të cilat mbështeteshin te mendimet personale të autorëve, të cilat çuan, në disa raste, në interpretime që kundërshtuan ato të Profetit dhe sahabëve të tij. Fjala *ra'j* është një emër foljor, që do të thotë mendim, besim, analogji dhe sforcim. Teknikisht, është mendim i pavarur, që përdoret për të treguar interpretimin e Kuranit, përmes ushtrimit të mendjes për të kuptuar fjalën e Zotit, bazuar në njohuritë e shëndosha të gjuhës arabe dhe në zbatimin e parimeve të tefsirit. Gjithsesi, ky lloj i tefsirit ndahet në dy pjesë: *er Ra'j el Mahmud* ose *Memduh* (i lavdërueshëm), dhe *er Ra'jel Medhmun i fajësueshëm* (i qortueshëm). Çështja e Ra'jit (si i lavdërueshmi, ashtu dhe i fajësueshmi) si dhe ai i *israilijateve* (grupi i rrëfimeve që vijnë nga traditat hebraike dhe të krishtera) do të diskutohen më hollësisht në kapitujt vijues.

Ra'ji i qortueshëm është përdorur gjithashtu, për të interpretuar kuptimet e Kuranit, në një mënyrë të tillë, që më vonë u quajt "tefsir sektarian". Për më tepër, rrëfimtaret e tregimeve (*kusas*) shkuan duke u përfshirë më shumë në këtë periudhë të interpretimit kuranor, duke përdorur një imagjinatë të jashtëzakonshme dhe duke marrë lëndë nga burimet legjendarre. Shembulli më i njohur i kësaj prirjeje mbase mund të jetë Muxhahid ibn Xhebri. Për shembull, interpretimi prej tij i ajeteve juranore 75: 22-23: "*Vuxhuhn jeumeidhin nadiratun ila Rabbiha nadhiratun*" (Atë ditë, disa fytyra do të shkëlqejnë dhe Zotin e tyre do të shohin), kundërshton atë të Profetit. Ndërkohë që, sipas hadithit autentik të Profetit dhe tefsirit të sahabëve të tij, këto ajete i referohen fytyrës së Allahut, që muslimanët do ta shohin me sy të lirë në Ditën e Gjykimit, Muxhahidi e shpjegon fjalën (*nadhirah*) sikur nënkupton se muslimanët do të presin një shpërblim nga Zoti, që sipas tij do të thotë se muslimanët nuk do ta shohin Allahun në Ditën e Gjykimit. Për-

kundër kësaj, interpretimi i Muxhahidit, më vonë, u mor nga mu'tezilitët dhe u identifikua me ta, në vend që të lidhej me Muxhahidin, autorin e tij.<sup>43</sup>

Dijetarë të tjerë të shquar, veçanërisht, Hasan el Basriu (vd. 110 h.) dhe Katade ibn Du'ame, janë akuzuar se kanë përdorur argumente sektare në tefsirin e tyre.<sup>44</sup> Për shkak të këtyre prirjeve, sidomos përdorimi i burimeve *israilijate* (si hebraike dhe të krishtera) dhe mbështetja në mendimin subjektiv (*Ra'j*), pa iu mbështetur traditës profetike ose sahabëve në shpjegimin e disa fragmenteve kuranore, disa dijetarë bënë kujdes të madh karshi interpretimeve të Muxhahidit, Ikrimes, Zejd ibn Eslemit dhe mbështetësve të tyre. Ata mendonin se *ra'ijatet* dhe *israilijatet* ishin bërë pjesë e tefsirit të tyre.<sup>45</sup> Dijetarë të tjerë, si Kasim ibn Muhamed ibn Ebu Bekr (vd. 106 h.), një nga nipat e Ebu Bekr es Sidikut, dhe Ubejdullah ibn Hafs (vd. 280 h.), një stërnip i Omer ibn Hatabit, i janë shmangur krejtësisht interpretimit kuranor, për të shmangur akuza të tilla.<sup>46</sup>

Një nga autorët e shquar të periudhës së këtyre studiuësve ishte Mukatil ibn Sulejman. Vepra e tij madhore *El Vuxhuh ve el Nedha'ir*, mendohet se është vepra e parë e plotë mbi *ra'jin* (një shqyrtim i hollësishëm i saj do të jepet në kapitullin tre). Tefsiri i kësaj periudhe klasifikohet edhe si “më i miri” dhe “më i keqi”. Më i miri shihet ai tefsir që nuk përmban *ra'ijate* dhe më i keqi shihet ai që bazohet tërësisht në *ra'ijate* ose opinione. Ndër veprat më të mira, janë ato të Ibn Abasit, Muxhahidit dhe të tjerëve. Ndër më të këqijat, janë ato të Ed Dahakut dhe të Ebu Salihit.<sup>47</sup>

---

43 Esh Sheukani, Muhamed ibn Ali, *Fet'h el Kadir el Xhami bejn fennaj er Rivajeh ve ed Dirajeh min Ilm et Tefsir* (Bejrut: Mahfuz el Ali, nd), vëll. 5, f. 338.

44 Ibn Haxher, *Tehdhib et Tehdhib*, vëll. 1, f. 263.

45 Ibn Sed, *Et Tabakat el kubra*, vëll. 5, f. 467. Shih Dhehebi, *Sijer alam en Nubela*, vëll. 4, f. 45.

46 Goldziher, Ignaz, *Muslim Studies*, përkthyer nga gjermanishtja C.R. Berber dhe S.M. Stern, 2nd edn., (Chicago: Aldine, New York, Altherton, n.d.), vëll. 2.

47 Nabia Abbott, *Studies in Arabic Literary Papyri II: Qur'anic Commentary and Tradition* (Chicago: The University of Chicago Press, 1967), f. 112.

## TEFSIRI PAS EPOKËS SË PASUESVE (TABIUNËVE)

Në fund të shekullit të dytë, nxënësit e sahabëve të Profetit, tabiunët, kishin vdekur. Asnjë interpretues i asaj periudhe nuk prodhoi vepra kushtuar ekskluzivisht (posaçërisht) interpretimit kuranor. Është thënë tashmë, se Muxhahidi shkroi një tefsir të plotë të Kuranit. Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të dytë, dijetarë të ndryshëm filluan përpilimin e punimeve rreth Kuranit, sipas specializimit dhe interesave të tyre. Tefsiri ishte zhvilluar tashmë, si një specialitet i tillë. Dijetarë ose tradicionalistë (hadithologë), të tillë si Shu'beh ibn El Axhaxh (vd. 160 h.),<sup>48</sup> Ibn el Vard (vd. 160 h.),<sup>49</sup> Vaki ibn el Xherrah (vd. 197 h.) dhe Sufjan ibn Ujejne ibn Mejmun (vd. 198 h.),<sup>50</sup> i kushtuan vëmendje të veçantë transmetimit të tefsirit që i atribuohet Profetit, sahabëve të tij dhe tabiunëve. Gramatikanët dhe gjuhëtarët shkruan vepra origjinale mbi Kuranin, duke shpalosur ekspertizën e tyre. Disa nga këto punime përfshijnë *Me'ani el Kur'an*, me autor Ebu Zekerija Jahja ibn Zijad el Ferra (vd. 207 h.), dhe *Mexhaz el Kur'an*, nga Ebu Ubejde ibn Mu'amer ibn el Muthenna et Tejmi (vd. 204 ose 224 h.).<sup>51</sup> Punimi i El Ferras përmbante një sasi të vogël të interpretimit kuranor nga Profeti, sahabët e tij dhe tabiinët.<sup>52</sup>

48 Shu'beh ibn el Axhaxhit iu dha titulli "Emir el Mu'minin fi el Hadith" (Prijësi i Besimtarëve në Hadith). Ai ishte dijetari i parë që ka bërë një studim kritik të Hadithit. Ai u përshkrua si një thikah. Dhehebi, *Tedhkirat el Huffaz*, vëll. 1, f. 19. Ibn Tejmije, *Mukaddime fi usul et tefsir*, f. 105

49 Vaki ibn el Xherrah ishte i njohur për kujtesën e tij të jashtëzakonshme. Një nga bashkëkohësit e tij ka thënë se e dëgjoji atë duke cituar 700 hadithe përmendësh. Ai konsiderohet si një nga dijetarët e shquar të Hadithit. Shih, Abdurrahman ibn Muhamed ibn Ebu Hatim et Temimi er Razi, *Kitab el Xherh ve el Teadil*, (Indi: Matbah el Mexhlis D'irat el Me'arifeh el Uthmanijeh, 1952/1371, vëll. 1, f. 219-220.

50 Sufjan ibn Ujejne kishte reputacionin e të qenit më i ditur dhe ekspert i haditheve në Hixhaz (Mekë dhe Medinë). Ishte një nga studiuesit e shquar të Hadithit. Ai është përshkruar si një thikah. Shih, Er Razi, *Kitab el Xherh ve et te'dil*, vëll. 1, f. 32-35.

51 Ebu Ubejde el Muthenne et Tejmi ishte një gjuhëtar i shquar dhe njeri me shkrim-lexim. Dhehebi, *Sijer el alam en Nubela*, vëll. 1, f. 369.

52 Botuar në tri vëllime nga Ahmed Jusuf Nexhati dhe Ali Nexhar, në 1955.

Sipas Ibn Halikanit, një person i quajtur Ibrahim ibn Ismail e kishte pyetur Ebu Ubejden rreth disa kuptimeve të Kuranit. Pasi ia shpjegoi kuptimet e kërkuara, Ebu Ubejde iu përvesh punës së shkrimit të një libri që shpjegon kuptimet e Kuranit.<sup>53</sup> Punimi i qaset Kuranit nga këndvështrimet gjuhësore dhe gramatikore dhe, gjithashtu, përfshin shpjegime të fjalëve të vështira, të njohura si *garib*. Ai e përdori poezinë gjerësisht si pjesë e shpjegimeve të tij. Vepra është botuar në një vëllim të përgatitur nga Fuat Sezgin, në vitin 1959.

Këto qasje, si dhe metodologjitë e përdorura nga gramatikanë e gjuhëtarë dhe nga hadithologët lulëzuan deri në fund të shekullit të tretë dhe në fillim të shekullit të katërt. Prandaj, literatura e tefsirit u nda nga trupi kryesor i literaturës së Hadithit. Të dyja u zhvilluan si shkenca të pavarura.

Pas ndarjes së literaturës së tefsirit nga trupi kryesor i Hadithit, secila u bë një shkencë e pavarur me literaturën dhe çështjet e veta. Literatura e Hadithit, për shembull, ka të bëjë me përcjelljen e rrëfimeve vetëm mbi veprimet dhe thëniet e Profetit.

Këto rrëfime ishin objekt i hulumtimit intensiv gjatë dy shekujve të parë të epokës islame. Ato u mblohdën në shumë përpilime të shkruara dhe gradualisht, gjashtë prej tyre u njohën në shumicën, në mos të gjitha, qarqet sunite, si më autentike. Këto gjashtë përmbledhje quhen teknikisht *El Kutub es Sitte* (gjashtë librat autentikë të hadithit) dhe janë:


- *El Xhami es Sahih* nga Ebu Abdullah Muhamed ibn Ismail el Buhari.
- *Sahih Muslim* nga Ebul Hasan Muslim ibn el Haxhaxh el Kushejri..
- *Sunen Ebu Davud* nga Ebu Davud Sulejman ibn el Esh'ath es Sixhistani.

---

53 Ahmed ibn Muhamed ibn Ebu Bekr ibn Halikan, *Vefejat el Ajan ve enba eba ez zaman*, (Kajro: Maktabeh en Nahdah el Misrijje, 1948-1950), vëll. 1, f. 139. Shih edhe Nasr Hamid Ebu Zejd, *Atijje el akli fi et tefsir: Dirasah fi Kadijjat el Mexhaz fi el Kur'an inde el mu'tezileh* (Bejrut: Dar et Tanvir li et Tiba'ah ve en Neshr, 1982), f. 100.

- *El Xhami es Sahih* ose Sunen et Tirmidhi nga Ebu Isa Muhamed ibn Isa et Tirmidhi.
- *Sunen en Nesai* nga Ebu Abdurrahman ibn Ali ibn Shu-ajb en Nesai.
- *Sunen Ibn Maxhe* nga Ebu Abdullah Jezid ibn Maxhe.

Literatura e tefsirit merret me pëcjelljen e dëshmime në lidhje me shpjegimin e Profetit të Kuranit, si dhe ato të shokëve dhe tabiinëve, së bashku me qasjet gjuhësore, retorike, juridike dhe teologjike. Këto dëshmi dhe qasje u bënë objekt studimi intensiv, pas ndarjes midis Hadithit dhe tefsirit. Literatura e tefsirit u nda përfundimisht në dy lloje kryesore, të njohura teknikisht si *et tefsir bi el me'thur* dhe *et tefsir bi er ra'j*. Veprat e tefsirit *bi el me'thur* përfshijnë libra të tilla, si *Xhami el bejjan an Te'vil ajat el Kur'an* nga Muhamed ibn Xharir et Tabari; *El Muhrrir el Vexhiz fi et Tefsir el Aziz* nga Abdulhak ibn Ghalib ibn Atije dhe *Tefsir el Kur'an el Adhim* nga Imadudin Ismail ibn Kethir. Shembuj të vep-rave të tefsirit *bi er ra'j* janë *Et Tefsir el Kebir*, i njohur gjithashtu si *Mefatih el Gajb*, nga Muhamed ibn Omer Fahrudin er Razi; *El Bahr el Muhit* nga Etherudin ibn Jusuf Ebu Hajjan dhe *El Kash-shaf an haka'ik ve gavamid et tenzil ve ujun el Akavil fil vuxhuh et te'vil*, nga Ebu Kasim Mahmud ibn Amr ibn Muhamed ez Ze-mehshari.



## KAPITULLI II

# TEFSIRI NË SHEKUJT E TRETË DHE TË KATËRT HIXHRI

### Përmbledhje

1. Ekziston një sasi shumë e madhe veprash në shpjegimin kuranor. Edhe pse dijetarë të caktuar dhe veprat e tyre i kanë rezistuar kohës dhe qëndrojnë në pah më të madh prej të tjerëve, për t'i dhënë kuptim gjithë këtij deti literature në tërësi, studiuesit janë përpjekur ta kategorizojnë atë.
2. Dy kategoritë kryesore për të kuptuar komentaret e Kuranit, sipas dijetarëve, janë *et tefsir bi el me'thur* (komentarë të bazuar në hadith) dhe *et tefsir bi er raj* (komentarë të bazuar në opinion).
3. Këto janë të rëndësishme dhe nën këto dallime u shkruan vepra të panumërta në *tefsir*, që do të thotë: komentarë kuranorë, të ndarë edhe këta në nënkategori. Këto nënkategori mund të klasifikohen në terma të thjeshtë, p.sh. suni, shia, sufi etj., dhe nën ato më komplekse, p.sh. a) *ihtisar el esanid*, b) koha e specializimit dhe c) *tefsir el bid'a*. Nën këto kategori, kemi nënkategori të gjuhësisë, drejtësisë, gramatikës,

interpretimit mistik etj. Çdo nënkategori dhe tejnënkategori përcaktohet nga veprat kryesore diturake të cilat e tipizojnë atë.

4. Përveç nënkategorive, gjithashtu hasim qasje të ndryshme të brendshme në interpretimin kuranor, ose metodologji të cilat janë përdorur përgjatë historisë. Një pjesë janë të sakta dhe mbështeten në zinxhirë të plotë të transmetimit të hadithit, një pjesë tjetër me theks më shumë interpretues, deri në atë pikë, sa për t'u konsideruar risi ose *bid'a*. Ideja e përgjithshme duket të jetë që komentaret më klasikë dhe autentikë ndjekin shpjegimin kuranor bazuar në metodologjinë rigoroze të përdorimit të haditheve të sakta (*et tefsir bi el me'thur*), kurse komentaret me theks më interpretues (rrjedhimisht më pak të përdorur) ndjekin qasje më pak rigoroze të bazuara mbi mendimin (*et tefsir bi er raj*).
5. Ndërsa shkruhej secili komentari kuranor, natyrshëm kishte në dispozicion tërësinë e punimeve që ishin botuar tashmë para tij, dhe në një shkallë më të vogël ose më të madhe, do të ndikohej prej saj. Për të thjeshtuar kronologjinë, periudhën e përgjithshme historike e kemi klasifikuar si a) epoka nga Profeti deri te Pasuesit, pastaj b) deri Taberiu (i cili shkroi një nga të parat punime gjithëpërfshirëse dhe që është komentari më i hershëm kryesor i Kuranit që ka mbijetuar në formën e tij origjinale). Më pas c) shekujt e tretë dhe të katërt, fokusi i këtij kapitulli, kur shpjegimi kuranor u zhvillua më tej. Pastaj kalojmë në kohën tonë moderne dhe orientalizmin, i cili përfaqësohet nga studiues të tillë, si hungarezi Ignaz Goldziher që konsiderohej si themeluesi i studimeve islamike moderne në Europë.

Në shekullin e tretë dhe të katërt shkrimi i tefsirit u zhvillua më tej. Përcjellja e tefsirit me një zinxhir të plotë të transmetimit (*isnad*) u bë i njohur dhe filloi të tërheqë vëmendjen e teologëve dhe leksikografëve, si specializim në një nga aspektet e interpretimit të

Kuranit. Kështu, ata filluan të prodhojnë komentare tefsiri të karakterizuar nga një tipar dallues i dukshëm.

Veprat më të shquara, por që nuk janë ruajtur, përfshijnë komentare nga Ebu Abdullah Jezid ibn Maxhe (vd. 273 h.),<sup>54</sup> Abdurrahman ibn Ebi Hatim (vd. 304 h.)<sup>55</sup> dhe El Husejn ibn Davud el Mesisi, i njohur si Sunejdi. Sipas Ibn Tejmijes, veprat e këtyre hadithologëve të veçantë mbështeteshin vetëm në thëniet e Profetit, sahabëve dhe tabiinëve.<sup>56</sup>

Ndër veprat e shquara, të hartuara nga leksikografë dhe gjuhëtarë, ishin *Tefsir garib el Kur'an*, nga Ibn Kutejbe (vd. 276 h.), dhe *El Mufradat fi garib el Kur'an*, nga Ragib el Esfahani (vd. 502 h.). Kjo e fundit besohet të jetë vepra më e mirë në këtë fushë. Këto vepra shqyrtojnë vështirësitë leksikore të fjalëve kuranore. Gjatë kësaj periudhe, Ebu Xhafer Muhamed ibn Jezid et Taberi paraqiti një metodologji dhe qasje të dallueshme nga bashkëkohësit e tij. Tefsiri i Taberiu, *Xhami el Bejan an Te'vil el Kur'an*, përgjithësisht pranohet të jetë puna më gjithëpërfshirëse e tefsirit, e hartuar nga dijetarët muslimanë dhe jomuslimanë.<sup>57</sup> Në veprën *Et Tefsir ve el mufessirun*, Dhehebiu, si bashkëkohës gjithashtu, pohoi që metodologjia e zbatuar nga Taberiu në veprën e tij ishte e pashoqe. Këto dy pretendime u sfiduan nga Ibn Hazmi.<sup>58</sup>

54 Muhamed ibn Jezid ibn Maxhe ishte një nga autorët e gjashtë librave të famshëm të njohur si *El Kutub es Sitte* në shkencën e Hadithit. Ai konsiderohet si një "Imam në Hadith" (mjeshtër kryesor në Hadith). Shih Dhehebi, *Sijer alam en Nubela*, vëll. 13, f. 277-279.

55 Abdurrahman ibn Muhamed ibn Ebu Hatim et Temimi er Razi, ishte një kritik i famshëm i Hadithit. Ndër veprat e tij, janë *Kitab el Xherret teadil, il el hadith*. Dhehebi, *Sijer alam en Nubela*, vëll. 1, f. 468.

56 El Husejn ibn Davud el Mesisi, i njohur si Sunejdi. Ai u përshkrua si hafiz, njeri me një kujtesë të fortë, domethënë ai memorizoi një numër të madh hadithesh. Shih Ibn Tejmije, *Mukaddime fi usul et tefsir*, f. 78-80.

57 Goldziher vërejti: "Po të kishte arritur ky libër tek ne, nuk do të kishim nevojë të lexonim punën e gjeneratës së mëvonshme në tefsir" (minierë përkthimi), Goldziher, *Die Richtungen der Islamischen Koranauslegung* (Leiden, Brill. 1920), f. 85-86.

58 Ibn Hazmi konsideron se tefsiri i Baki ibn Makhlad ibn Jezid (vd. 273 h./ 889) ka tejkaluar punën e Taberiu. Ai, më tej, deklaroi se asnjë vepër tefsiri nuk mund të krahasohet me Bakin. Shih Ibn Bashkuvl, *Kitab es silah* (Kajro: Ed Dar el Misrijeal li et Terxhemeh, 1996). Gjithashtu, Ibn Ashur deklaroi se Taberiu i detyrohet në metodologjinë e tij veprës së Jahja ibn Selemit, ku kombinon etherin dhe aklin (transmetimin dhe mendjen). Shih Ibn Ashur, *Et Tefsir ve er Rixhaluh*, f. 37.



## ZHVILLIME TË RËNDËSISHME PAS TABERIUT

Pas shekullit të katërt, tre zhvillime kryesore ndodhën në fushën e komentimit kuranor. Sipas këndvështrimit të Sujutit, këto ishin a) *ihtisar el esanid*, që do të thotë shkurtimi i zinxhirëve të transmetimit (shoqëruar me deklarime të paverifikuara), b) moshë e specializimit dhe c) *tefsir el bid'a* (interpretimi heretik), d.m.th. shfaqja e komentimeve jo besimdrejta.<sup>59</sup>

Ekziston një kategori tjetër që nuk përmendet nga Sujuti, e cila është *Nazm el durar fi tenasub el ajat ve el suver*. Kjo ka të bëjë me marrëdhëniet ndërmjet sureve të Kuranit, nga njëra anë, dhe ndërmjet ajeteve në secilën sure, nga ana tjetër. Edhe pse disa dijetarë si Ez Zerkeshi në veprën e tij *El Burhan fil ulum el Kur'an*, Raziu në veprën e tij *Et Tefsir el kebir*, dhe të tjerë e kanë cekur këtë temë shkurtimisht.

### a) *Ihtisar el Esanid dhe përdorimi i të dhënave të pasigurta*

Shkurtesa e një zinxhiri të transmetimit është e njohur në shkencën e Hadithit si *ihtisar el esanid*. Në vend që të përsërisnin emrin e secilit mësues ose transmetues në një zinxhir të caktuar të transmetimit (*isnad*), dijetarët muslimanë filluan të hiqnin dorë nga *isnadi* i plotë që shkonte kundër metodologjisë së dijeve islamike, sepse kjo tendencë nuk e bënte të detyrueshëm verifikimin e burimeve të informacionit. Ishte e zakonshme dhe e lehtë pra, për të cituar ose miratuar një dëshmi nga burime të paqena ose jo të besueshme. Si pasojë, shumë tekste ishin shkruar nga një akademizëm dhe standard i tillë i dobët, saqë autorët e tyre nuk bënë dallim midis të

59 Sujuti, *El Itkan*, vëll. 2, f. 419. Shih gjithashtu, Muhamed Abduadhim ez Zarkani, *Menahil el irfan fi ulum el Kur'an*, vëll. 2, f. 32-33.

dhënave të sakta dhe të pasakta. Përveç kësaj, autorët e tillë nuk i dallonin interpretimet shkencore nga pjesa tjetër.<sup>60</sup>

Një vepër madhore e tefsirit që përfaqëson të tjerët në lidhje me prirjen e *ihtisar el esanid* dhe përdorimin e informacionit të pa-verifikuar, është *Tefsir el keshf vel bejan an tefsir el Kur'an*, me autorësi të historianit Thealebi (vd. 427 h). Ajo kryesisht përbëhet nga tregime të hollësishme të historive, pa i kushtuar vëmendje kritike vërtetësisë së tyre, domethënë, nëse informacioni i përmbajtur është i vërtetë apo i rremë.<sup>61</sup> Përveç disa haditheve që janë të sakta, Thealebi gjithashtu transmeton një numër hadithesh, të cilat janë të dobëta dhe të trilluara, pa bërë dallimin mes tyre. Ai pretendon se i kishte mbledhur të dhënat e tij nga rreth njëqind libra dhe deklarata që kishte marrë nga rreth treqind dijetarë.<sup>62</sup>

Thealebi na informon në *Hyrjen* e tij, se tefsirin e kishte shkruar në përgjigje të një kërkesë nga disa njerëz dhe se ai dëshironte, pra, të shkruante një vepër gjithëpërfshirëse, autentike, të shkurtër, të kuptueshme dhe të organizuar mirë të tefsirit, si sfidë ndaj veprave që përmbanin zinxhirë të gjatë transmetimi, duke përsëritur transmetime të ndryshme me linja të panevojshme të transmetuesve, të tilla si vepra e Taberit, të cilin ai e kritikoi. Megjithatë, vetë Thealebi përfshin një numër të konsiderueshëm rrëfimesh dhe *israilijatesh*, përveç çështjeve gjyqësore, përcaktimeve gramatikore dhe traditave që burojnë nga Profeti, sahabët dhe tabi'inët. Në fakt, Ibn Kajimi (vd. 701) ishte aq kritik ndaj Thealebit për rrëfimin e haditheve të dobëta, sa që ai shkroi version të redaktuar të tefsirit të këtij autori.<sup>63</sup>

60 Sujuti, *El Itkan*, vëll. 2, f. 419.

61 Muhamed Husein edh Dhehebi, *Et Tefsir ve el mufessirun*, bot. i parë (Kajro: Dar el Kutub el Haditheh, 1961/ 1381). f. 29.

62 Ibn Tejmije, *Mukaddime fi usul et tefsir*, fq. 76; Sujuti, *El itkan*, vëll. 2, f. 419.

63 *The Encyclopedia of Islam*, vëll. II, E-K (Leiden, London: E.J. Brill, Luzac, 1927), vëll. 7, f. 735-736; Muhamed Husein edh Dhehebi, *Et Tefsir ve el mufessirun*, vëll. 1, f. 228.

## b) Periudha e Specializimit

Sujuti dhe të tjerë e konsiderojnë periudhën nga shekulli i pestë e këtej, si ajo e epokës së specializimit në tefsir, sepse ekspertët shkruan interpretime kuranore vetëm nga këndvështrimi i fushës së tyre të specializimit të veçantë, me theks në analizën gramatikore, juridike dhe teologjike. Fjala specializim e përdorur këtu, nuk duhet të kuptohet në kontekstin e saj modern. Duhet të kuptohet më saktë, si një referencë ndaj elementit më dominues që shfaqet në vepër, nga fillimi në fund. Shkalla në të cilën një element i veçantë e dominon veprën, përcakton specializimin e saj.

### (i) Tefsiri Gramatikor

Ndër përfaqësuesit e interpretimit gramatikor, ishin *Me'ani el Kur'an* nga Ez Zexhaxhi (vd. 316 h.);<sup>64</sup> *El Vasif fi tefsir el Kur'an el Mexhid*, *El Vaxhiz fi tefsir el kitab* nga El Vahidi (vd. 468 h.); si dhe *El bahr el muhit* nga Ebu Hajan (vd. 745 h.). Diskutimi që vijon, përqendrohet në këtë të fundit, sepse është konsideruar si vepra e parë gjithëpërfshirëse dhe më e rëndësishme për tefsirin gramatikor.<sup>65</sup>

Ebu Hajjan Muhamed ibn Jusuf ibn Ali Hajjan el Endelusi filloi të shkruajë tefsirin e tij në moshën pesëdhjetë e shtatë vjeçare. Ai deklaroi se e shkroi librin e tij për kënaqësinë e Zotit. Metodologjia dhe qasja e tij ishte që, së pari, të shpjegonte çdo ajet fjalë për fjalë, ndjekur nga një diskutim gramatikor dhe gjuhësor. Kur një ajet kishte më shumë se një kuptim, ai e përmend atë dhe pastaj vazhdon diskutimin rreth rastit mbi të cilin ishte shpallur një ajet i veçantë. Këtë e pasonte me një prezantim të leximeve të ndryshme të pranuar dhe të refuzuara të një fragmenti, duke përfshirë një diskutim të këndvështrimit të tyre

64 Ebu Is'hak Ibrahim ibn es Sari ibn Sehl, i njohur si Ez Zexhaxh. Shih Ibn Kethir, *El bidajeh ve en nihajeh*, ed., Muhamed Abdulazziz en Nexhdi (Rijad: Mu'assasah el Kutub, p.d.), vëll. 12, f. 147.

65 Muhamed Husejn edh Dhehebi, *Et Tefsir ve el mufessirun*, vëll. 1, f. 138-139.

gramatikor. Një lexim tekstual konsiderohej i pambështetur, nëse kundërshtonte tekstin kanonik të mbledhur nga halifi Othman ibn Affan, ose që ishte në kundërshtim me kuptimin e pranuar të gjuhës arabe.<sup>66</sup>

Më në fund, Ebu Hajani citonte thënie nga tabiinët (brezi pasues i katër Halifëve të Drejtë). Kur një fragment kishte të bënte me çështje gjyqësore, ai paraqet mendimin e secilit prej krerëve të katër shkollave juridike sunitë të mendimit: Imam Ebu Hanifes, Malik Ibn Enesit, Muhamed ibn Idris esh Shafiut dhe Ahmed ibn Hanbelit.<sup>67</sup>

## (ii) Tefsiri i dispozitave (Tefsiri i Fikhut ose Ligjit islam)

Tefsiri ligjësor. Ekzistojnë tri tekste kryesore të interpretimit juridik me të njëjtin emër. Ato janë: *Ahkam el Kur'an* nga Ebu Bekr ibn Ali er Razi, i njohur si El Xhesas (vd. 370 h.); *Ahkam el Kur'an* nga Ebu Hasan Imadudin Ali Muhamed ibn Ali et Taberi, i njohur si El Kija el Hurasit (vd. 504h.); dhe *Ahkam el Kur'an* nga Muhamed ibn Abdullah ibn Muhamed el Me'arif, i njohur si El Kadi Ebu Bekr ibn el Arabi (vd. 543 h.).

Megjithëse autorët trajtuan përgjithësisht çdo kapitull të Kuranit, ata i dhanë shpjegim vetëm atyre ajeteve që kanë të bëjnë me aspektet juridike.<sup>68</sup>

Një tipar tjetër i përbashkët i këtyre autorëve, ishte animi i tyre ndaj shkollave të tyre të veçanta të mendimit. Xhesasi ishte hanefi, Kija el Hurasit ishte shafi dhe Ibn el Arabi ishte maliki. Megjithatë, secila nga veprat e tyre përmbante nga traditat që burojnë nga Profeti Muhamed, sahabët dhe tabi'inët, si dhe diskutime gramatikore dhe gjuhësore. Qasja e Xhesasit ishte të sistemonte veprën e tij

66 Libri u botua në tetë vëllime nga Dar el Kutub në Egjipt. Puna u konsiderua tefsiri i parë gramatikor në kuptimin e mbulimit të tërë Kuranit. Shih Muhamed Husejn edh Dhehebi, *Et Tefsir ve el mufessirun*, vëll. 1, f. 138-139.

67 Ebu Hajan, Muhamed ibn Jusuf ibn Ali el Andaluzi, *El bahr el muhit*, vëll. 1, f. 5.

68 Muhamed Husejn edh Dhehebi, *Et Tefsir ve el mufessirun*, vëll. 2, f. 416-429.

sipas literaturës juridike të *usuli fikhut*. Ai diskutoi secilën çështje nën një seksion të veçantë (*fasl*) ose kapitull (*bab*). Ai përfshiu pjesë të Kuranit për të shpjeguar ajete kuranore dhe hadithe për të mbështetur shkollën e tij të mendimit.

Nga ana tjetër, Ibn el Arabi do të përmendte emrin e sures kuranore që ai synonte të shpjegonte, ndjekur nga numri i përgjithshëm i ajeteve të cilat kishin të bënin me çështje juridike. Pastaj, ai numëron çështjet juridike që kanë të bëjnë me disa ajete, duke theksuar, për shembull, se ka pesë çështje juridike në ajetin e parë dhe dhjetë të tjera në ajetin e dytë, etj. Në mënyrë të ngjashme, ai përfshin pasazhe të Kuranit, sikurse bëri edhe Xhesasi.

Një interpretim tjetër i shquar, i denjë për t'u përmendur në këtë drejtim, është *El Xhami li ahkam el Kur'an*, nga juristi Ebu Abdullah Muhamed el Kurtubi (vd. 671 h.). Dijetari bashkëkohor egjiptian Muhamed Dhehebi shkroi që Kurtubi ishte një enciklopedi dhe se puna e tij ishte ndër komentaret më madhorë, nga të cilët njerëzit thjesht mund të përfitonin. Ishte i organizuar mirë dhe jashtëzakonisht i përdorshëm.<sup>69</sup> Studiuesit modernë e kanë klasifikuar komentarin e tij si Jurisprudencë.<sup>70</sup> Vlen të përmendet, megjithatë, se, nganjëherë, Kurtubi u përfshi aq shumë në fushën e çështjeve ligjore, saqë ai diskutonte probleme që nuk ishin të rëndësishme për vargjet e veçanta që ai po interpretonte.

Për më tepër, ai pohon në hyrjen e tij, se kishte vendosur që pjesën tjetër të jetës së tij t'ia kushtonte interpretimit kuranor dhe të përdorte gjithë forcën e tij për të shkruar një tefsir që do të përfshinte gjuhësinë, versionet e leximeve kuranore si dhe gramatikën, dhe se do të qortonte mendimet e njerëzve të çoroditur (ata që shtrembërojnë kuptimet e Kuranit). Ai shton se do t'u referohej shumë haditheve, thënieve të sahabëve dhe të tabi'ineve, në mbështetje të pikëpamjeve të tij mbi çështjet gjyqësore.<sup>71</sup>

69 Po aty, vëll. 2, f. 430-435.

70 Muhamed ibn Ali Shemsudin ed Davudi, *Tabakat el Muffesirin*, vëll. 2, f. 66.

71 Ebu Abdullah Muhamed ibn Ahmed el Ensari el Kurtubi, *El Xhami li ahkam el Kur'an* (Kajro: Dar el Kutub el Arabijje li et Tibah ve en Neshr, 1967/1387), vëll. 1, f. 2-3.

## RRETH LIBRIT

Krijimi i një domethënieje të saktë të Kuranit dhe kuptimi i vërtetë i vargjeve të tij është, padyshim, thelbi i shkencës më të rëndësishme të Islamit, shpjegimit kuranor ose Tefsirit. Që nga ndërrimi jetë i Profetit, shumë dijetarë kanë punuar zellshëm për të sjellë një kuptim të duhur të domethënies së Kuranit për muslimanët dhe për krejt botën, sa më plotësisht të jetë e mundur, në një përpjekje për të zgjeruar njohuritë e udhëzimeve që përmbahen aty dhe për të jetuar jetën në përputhje me ato parime.

Rezultati ka qenë një pasuri e literaturës historike muslimane mbi këtë temë e cila është e njohur si *Ulum et Tefsir*, ose shkencat e tefsirit, shpjegimi sistematik i Kuranit, duke ndjekur disa metodologji të caktuara. Kjo veprë gjurmon zhvillimin e shpjegimit kuranor, nga koha e Profetit, sahabëve, pasardhësve dhe mufessirëve (interpretuesve) të hershëm me vepra të pavarura tefsiri, deri në ditët e sotme. Duke vepruar kështu, shqyrtohen disa çështje madhore, duke përfshirë atë se deri në çfarë mase tefsiri është ndikuar nga traditat e ndryshme teologjike (klasike, sufiste mistike, persiane), interesa politike dhe sektare, çështje historike dhe gjuhësore, etj. Njëkohësisht, pasqyrohet mënyra se si interpretimi ka qenë i ndryshëm në disa raste, kryesisht në aspekte që kanë të bëjnë me çështje juridike, teologjike, historike dhe gjuhësore.

Disa studiues dhe komentues kuranorë i kanë rezistuar kohës dhe kanë një rëndësi më të madhe, krahasur me të tjerët. Janë paraqitur veprat e tyre si dhe janë krahasuar dhe kritikuar metodologjitë e ndryshme. Kësisoj, mbetemi me një pasqyrë të gjerë, por të rëndësishme, të një teme e cila, përndryshe, mund të jetë shumë komplekse dhe e gjerë për lexuesin e zakonshëm për ta kuptuar, si një vlerë e shtuar për kuptimin dhe studimin e Kuranit.



**Ali Suleiman Ali** është Imam i Komunitetit Musliman të Rret-hinave Perëndimore (MCWS) dhe Drejtor i Shërbimeve Familjare Muslimane (ICNARELIEF USA). I lindur në Gana, u diplomua në 1979, për Arabisht dhe Studime Islame, në Universitetin Islamik të Medinës. Ai vazhdoi studimet e mëtejshme në Universitetin e Miçiganit (Ann Arbor), ku mori një MA dhe PhD në Studimet Islame. Disertacioni i Dr. Ali mbi Tefsirin *bil Me'thur*, që merret me çështjen e *huxhah-s* (provës detyruese), ishte një studim thelbësor në një fushë të rëndësishme. Ai ka dhënë mësim për Studime Islame, Studime të Botës Muslimane, Arabisht dhe Shkencat e Kuranit në Universitetin e Detroit-Mercy, Universitetin Oakland, Auburn Hills, MI dhe Wayne County Community, SHBA.



ISBN 978-9928-126-38-2



9 789928 126382